



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Qytetërim Ballkanik

Ngarkesa në orë/kredite: 4 kredite; 40 orë mwsimore; 20 leksione*20 seminare

Viti / Semestri: Viti II, semestri I/II

Lloji i lëndës: Lëndë me përzgjedhje

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në Gjuhën Greke dhe Angleze”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Për një shekull, Ballkani është trajtuar si një entitet gjeopolitik, një fakt që është brendësuar nga vetë popujt që banojnë në territorin e tij. Në këtë lëndë do të bëhet një përpjekje për shqyrtimin ndërdisiplinor të kontributit të gjuhës dhe kulturës popullore në ndërtimin e kufijve realë ose simbolikë midis grupeve etnike që bashkëjetojnë në rajonin e Ballkanit. Duke përdorur gjuhën dhe kulturën si një kornizë dhe në të njëjtën kohë si një mekanizëm për mbështetjen dhe pranimin e kufijve, të dukshëm ose jo, do të nxjerrim në pah çështje thelbësore në lidhje me formimin e kufijve gjeografikë.

Objektivat specifike lëndore:

1. Konkretisht, studentët do të njihen me kontekstet shoqërore dhe kulturore të gjuhëve ballkanike. Do të shqyrtojnë mënyrat në të cilat një gjuha pasqyron mënyrat e jetës dhe besimet e folësve të saj, në kontrast me shkallën e ndikimit të gjuhës në kulturë. Do të shqyrtohen një larmi e gjerë kulturash dhe gjuhësh ballkanike.